



Progetto co-finanziato dall'Unione Europea




Regione Toscana




MINISTERO  
DELL'INTERNO

FONDO ASILO, MIGRAZIONE E INTEGRAZIONE (FAMI) 2014-2020

Obiettivo Specifico 1. Asilo - Obiettivo Nazionale 1. Accoglienza/Asilo - lett. C - Potenziamento del sistema di 1° e 2° accoglienza-Tutela della salute-PROG-2103 "SPRINT2



# KONTRACEPTIMI FALAS



Për të ditur më tepër e për të gjetur konsultorin më të afërt:  
[regione.toscana.it/contraccezione-gratuita](http://regione.toscana.it/contraccezione-gratuita)  
ose për të gjetur këto informacione në  
shumë gjuhë:  
<https://icare.sanita.toscana.it/it/>

Në Toscana **kontraceptimi është falas** për të favorizuar zgjedhje të ndërgjegjshme të mbrojtura, për një jetë seksuale të qetë të të rinjve dhe të të rriturve, për të ulur rrezikun e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe të shtatëzanive të pa dëshiruara.

## ♥ Kush ka të drejtë

Kontraceptimi është falas për të regjistruarit në Shërbimin Shëndetësor Nacional, rezidentë ose që jetojnë në Toscana, përfshirë edhe mbartësit e kodit STP (Të huaj Momentalisht Prezent) të cilët bëjnë pjesë në grupet e mëposhtme të popullsisë:

- Të rinjë nga 14 deri në 25 vjeç,
- Të rritur nga 26 deri në 45 vjeç me kod përjashtimi E02- E90 - E91 - E92 - E93 - X01;
- Gra nga 26 deri në 45 vjeç; brënda 12 muajve nga lindja ose brënda 24 muajve nga ndërprerja e shtatëzanisë.

Gjithashtu edhe për të rinjë deri në 25 vjeç të regjistruar në Universitetin e Firenze, Pisa, Siena dhe Universitetin për të huaj në Siena, posedues të kartës së Studentit Universitar - Studente Toscana.

## Si të kërkosh kontraceptimin falas

Nëse je nga 14 deri në 24 vjeç, drejtohu Konsultorit të të Rinjëve. Nëse je nga 25 deri në 45 vjeç drejtohu Konsultoreve.

Hyrja është e drejtpërdrejtë, që do të thotë pa përshkrimin e një mjeku, mjafton ti paraqitesh personelit të Konsultorit dokumentin që jep të drejtën për kontraceptimin falas (teserën shëndetësore për rezidentët ose që jeton në Toscana, kartën e studentit ose STP, çertifikatë që tregon përjashtimin për pagesë, letrën e daljes nga spitali).

Për të ditur më tepër se si mund të hysh në Konsultore si të gjesh atë më të afërtin shko në linkun:

[regione.toscana.it/contraccezione-gratuita](https://regione.toscana.it/contraccezione-gratuita) ose në gjuhë të ndryshme në: <https://icare.sanita.toscana.it/it/>

## ♥ Cilët kontraceptivë janë në dispozicion falas

ot ekzistojnë disa mënyra kontraceptive të bazuar në principe të ndryshme, gjithsesi më i miri në absolut nuk ekziston. Zgjedhja varet nga nevojat personale dhe nga besimi, por mbi të gjitha nga vet gjëndja shëndetësore. Personeli shëndetësor i Konsultorit, të cilit do ti drejtohesh, do të dijë të të ndihmojë në zgjedhjen e mënyrës më të mirë për ty.

Kontraceptivët falas në dispozicion janë:

- Pilula estrogjen-progestogjen
- Fashë transdermale
- Unazë vaginale
- Dispositivë në mitër me edhe pa hormone (spirale)
- Dispositiv nën lëkurë
- Prezervativë

## ♥ Si të kërkosh kontraceptimin e emergjencës ose "pilulën e ditës tjetër"

Mbas një raporti seksual të pa mbrojtur ose jo të mbrojtur mirë me rrezik një shtatzani të pa dëshiruar është e mundur marrja e kontraceptimit të emergjencës ose "pilulës së ditës tjetër". Nuk është e nevojshme marrja e ilaçit menjëherë mbas raportit me rrezik, por preferohet të merret në 24/72 orët në vazhdim dhe jo më mbrapa se 120 orë.

Ilaçet për kontraceptimin e urgjencës janë falas për të njëjtat kategori të sipërpërmendura.

Mund të paraqitesh tek Konsultori më i afërt në ditët dhe oraret kur është mjeku gjinekolog prezent, për përshkrimin dhe për të ditur nëse është i disponueshëm.

Në ditët në të cilët Konsultori është i mbyllur duhet të drejtohesh tek urgjenca ku do të jepet ilaci.

"Pilula e ditës tjetër" nuk është një mënyrë mbi të cilën mund të vendoset kontraceptimi.